

TIRANË 2019



— RAPORT II - 3 MUJOR —
PRILL - QERSHOR 2019

➤ Hyrje

Protesta e dhjetorit 2018 ishte shfaqja më masive e revoltës studentore në historinë e tranzicionit. Kjo protestë arriti që në mungesë të drejtimit apo orientimit nga ndonjë subjekt politik apo shoqëror, t'i paraqesë qartë dhe t'i imponohet qeverisë me 8 kërkesa që lidheshin me reduktimin e tarifave, transparencën e shpenzimeve, përfaqësimin studentor, performancën në mësimdhënie dhe vetingun e titujve akademikë.

Si rezultat i masivitetit, qëndrueshmërisë dhe kërkesave të drejta, studentët i imponuan qeverisë dhe kryeministrit duke i detyruar të publikojnë **“Paktin për Universitetin”¹**, të shkarkojë nga detyra Ministren e Arsimit, Sportit dhe Rinisë znj. Lindita Nikolla, si dhe të zvendesoje të gjithë përfaqësuesit e Ministrisë në Bordet e Administrimit në universitetet publike në vend. “Paktin për Universitetin”, kjo paketë premtimesh dhe masash u shpall nga kryeministri në 19 Dhjetor 2018 në Universitetin “Ismail Qemali” në Vlorë dhe më pas u konkretizua në **11 VKM dhe 4 Urdhëra të Kryeministrit në 26 dhjetor 2018**, akte të cilat synuan të adresonin një pjesë të 8 kërkesave të formuluar dhe kërkuara nga studentët gjatë protestës.

Qëndresa Qytetare nëpërmjet nismës **“Arsimi në Fokus” me mbështetjen e Qendrës Olof Palme**, ka nisur monitorimin e implementimit të “Paktit për Universitetin” duke përfshirë çdo akt, afat, vendim apo iniciativë të adresuar në këtë dokument politikash.

Qëllimi i këtij monitorimi është nxitja e llogaridhënies dhe transparencës së zbatimit të masave të ndërmarra nga qeveria në kuadër të paktit dhe maksimizimi i përfitimeve të studentëve nëpërmjet fuqizimit dhe përfshirjes së tyre në këtë proces. Monitorimi synon gjithashtu të ushtrojë presionin e nevojshëm ndaj qeverisë për të implementuar në kohë dhe me cilësi premtimet e bëra në Paktin për Universitetin.

Njëkohësisht kjo nismë synon të ndërgjegjësojë palët e interesuara (studentë, pedagogë, OJF dhe aktivistë të shoqërisë civile), të veprojnë për të përfituar maksimumin nga “Pakti për Universitetin”, për studentët me qëllim final përmirësimin e cilësisë arsimore dhe jetës studentore.

Ky raport përkon me periudhën e dytë të monitorimit 1 Prill - 30 Qershor 2019.

Gjetjet, rekomandimet dhe opinionet e shprehura në këtë monitorim, nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të donatorit.

¹<https://ëëë.kryeministria.al/ëp-content/uploads/2019/01/PAKTI-P%C3%8BR-UNIVERSITETIN.pdf>

➤ Përse Monitorim?

Rëndësia e Monitorimit të “Paktit mbi Universitetin”:

1. Së pari nëpërmjet këtij monitorimi Qëndresa do të vlerësojë ndryshimet, përmirësimet dhe risitë që do të sjellë pakti qeveritar për universitetin në arsimin e lartë në Shqipëri përgjatë vitit 2019, në raport me cilësinë dhe plotësimin e kërkesave reale të studentëve.
2. Pakti për Universitetin është produkt i forcës së një proteste të pastër qytetare të orientuar tek kërkesat e një grupi shoqëror siç janë studentët dhe monitorimi i ecurisë së tij shërben si analizë që qytetarët shqiptarë të kuptojnë se protesta të tilla shërbejnë si precedentë positive nëse premtimet e qeverisë realizohen ose si precedentë negativë nëse faktehet që masat e qeverisë në kuadër të këtij pakti të mos zbatohen dhe të rezultojnë si mekanizma për të shuar protestën (pretendime të grupimeve të ndryshme gjatë protestës).

Kohështrirja

Ekipi i Qëndresës dhe i ekspertëve që do të marrin pjesë në monitorimin vjetor të “Paktit për Universitetin” për periudhën Prill – Qershor 2019, do të publikojnë çdo 3 muaj gjetje dhe rekomandimetë paraqitura këto në raporte 3 - mujore monitorimi, si dhe nje raport final përmbyllës në fund të vitit.

Konkretisht:

Raporti i Parë: Monitorimi i procesit përgjatë periudhës **Janar – Mars 2019**

Raporti i Dytë: Monitorimi i procesit përgjatë periudhës **Prill – Qershor 2019**

Raporti i Tretë: Monitorimi i procesit përgjatë periudhës **Korrik – Tetor 2019**

Raporti Final: **Janar – Dhjetor 2019**


➤ Kërkesat e Studentëve

Protesta e studentëve nisi me kërkesën për shfuqizim të tarifës së riprovimit në datën 5 Dhjetor 2018, tarifë të cilën qeveria e shfuqizoi vetëm një ditë pas protestës. Ditën e tretë studentët dolën me 8 kërkesa zyrtare drejtuar Kryeministrit dhe MASR, dhe pasi protesta arriti pjesëmarrjen më masive, qeveria pranoi kërkesat dhe në mungesë të dialogut ofroi në 19 dhjetor “Paktin për Universitetin” si përgjigje ndaj tyre.

8 kërkesat e studentëve në Protestën e Dhjetorit:

1. Rritje e buxhetit të arsimit në masën mundësimin e përgjysmimit të tarifës së studimit për çdo nivel studimi, përmirësimin e mësimdhënies dhe infrastrukturës.
2. Transparencë me buxhetin nga MASR dhe IAL-të, publikim i të gjitha shpenzimeve online.
3. Rritje e peshës së votës së studentëve nga 10% në 50% në zgjedhjet për strukturat akademike.
4. Bordi i Administrimit të ketë numër të barabartë anëtarësh nga IAL dhe MASR dhe një përfaqësues në këtë bord të jetë nga studentët.
5. Pajisja e të gjithë studentëve me Kartën e Studentit brenda vitit akademik 2018 – 2019.
6. Rishikimi i titujve akademikë dhe verifikimi i plagjiaturave të doktoraturave dhe teksteve mësimore.
7. Vlerësim i performancës në mësimdhënie dhe kërkim shkencor, publikimet online dhe regjistrimi i leksioneve.
8. Ndërtimi i bibliotekave me standarte Europiane dhe me libër universitar online falas për studentët në gjuhën shqipe.

50% e GDP me qëllim



➤ Metodologjia e monitorimit

Për të realizuar këtë monitorim është ndjekur metodologjia e grumbullimit të informacionit nga disa burime duke u nisur nga:

- a) Shfletimi i Fletores Zyrtare
- b) Verifikim i publikimeve të akteve të qeverisë
- c) Kronikat mediatike në televizione
- d) Publikimet zyrtare në faqet e internetit dhe rrjetet sociale të Kryeministrit dhe qeverisë.
- e) Institucioneve të përfshira dhe përgjegjëse për implementimin e Paktit për Universitetin i janë dërguar *kërkesa për informacion* për të grumbulluar të dhëna dhe vlerësuar procesin sipas të dhënave të nxjerra nga vetë institucionet.
- f) Janë zhvilluar takime periodike me studentë të 5 universiteteve të cilët kanë plotësuar fishën e raportimit mbi premtimet dhe afatet e “Paktit për Universitetin” të zbatuara në universitete, për të grumbulluar edhe informacion nga studentet si përfitues drejtpërdrejtë.

Për të realizuar këtë monitorim janë angazhuar ekspertë të fushës së arsimit dhe Rrjeti i Studentëve “Arsimi në Fokus”, grupim i cili synohet të fuqizohet dhe informohet gjatë implementimit të kësaj nisme.

Është synuar të paraqitet informacion i sintetizuar dhe lehtësisht i kuptueshëm se si qëndron:

- Raporti i kërkesave të studenteve dhe reflektimi i tyre në Paktin për Universitetin
- Niveli i efektivitetit të realizimit të premtimeve që parashikon “Pakti për Universitetin ” dhe statusi i tyre aktual.
- Raporti i transparencës së institucioneve dhe qeverisë mbi punën e realizuar 3 - mujorin e dytë nga shpallja e Paktit, duke vlerësuar komponentin e:
 - Publikimeve zyrtare
 - Komunikimeve publike
 - Përgjigjes së kërkesave për informacion

MONITORIMI I “PAKTIT PËR UNIVERSITETIN” PRILL – QERSHOR 2019

➤ **Gjetjet Kryesore** (Prill – Qershor 2019)

- **Karta e Studentit** dhe **Investimi ne konviket** u zbatua **vetëm në nivel lokal duke diferencuar studentët** e Tiranës nga ata të 5 bashkive të tjera universitare, të cilat nuk përfituan asnjë fond për investime në konvikte si dhe studentët e këtyre universiteteve të mos gëzojnë të drejtën ligjore për tu pajisur me Kartë Studenti.
- 35 antarët e rinj të Bordit të Administrimit përfaqësues të MASR u premtuan se do të ishin figura publike por **vetëm 13 prej tyre janë figura publike** ndërsa 22 anëtarë janë persona me profil të ulet sa i përket prezencës dhe informacionit që gjendet për ta në publik. Nga 35 anëtarët e emëruar, **18 janë funksionarë të administratës publike**, 8 nga bota akademike, 6 nga shoqëria civile dhe sektori privat dhe 3 nga fusha e gazetarisë.
- Procesi i zgjedhjes nga studentët i anëtarëve përfaqësues të MASR në bordet e administrimit **tejkaloj afatet e parashikaura**, u shoqëruan me **mungesë transparence dhe pjesëmarrje (11% në UT). Mungesa e rregullore specifike** mbi procesin e votimeve solli cënim të së drejtës së votës pasi MASR në disa raste përzgjedhi kandidatët jo në bazë të votave të studentëve por në bazë të kodit të procedurave administrative.
- **Buxheti në dispozicion të Kartës së Studentit** për vitin 2019 nga MASR **është 0 lek**. Karta e Studentit e prodhuar nga bashkia përmban 40 shërbime të miratuara nga Këshilli Bashkiak duke ofruar ulje për vizitat në muze, teatër e kinema por **nuk përfshin nevojat bazike të studentëve si transporti, ushqimi, kancelaritë, librat dhe komunikacioni**.
- Qeveria **nuk mbajti premtimin për nisjen e procesit të rishikimit të titujve shkencorë dhe kontrollit anti-plagjiaturë** brenda muajit Qershor 2019 sipas VKM nr. 777. Gjatë kësaj periudhe asnjë titull shkencor nuk është kontrolluar apo raportuar për plagjiaturë në universitete.

- Sondazhi Kombëtar i Studentëve **anashkaloi trajtimin e fenomenit të korrupsionit** në universitete për raste dhe emra specifike dhe **krijimin e dosjeve personale të pedagogëve** sipas vlerësimit të studentëve. Rezultatet e sondazhit nuk janë bërë ende publike megjithëse ky proces duhet të mbarontë në 2 Maj 2019.
- Biblioteka online përmban një numër të lartë të materialeve shkencore në gjuhë të huaj, megjithëse kjo platformë **kushtoi 687.825 USD** studentët nuk arrijnë të gjejnë **informacion që përkon me kurrikulat** e tyre mësimore dhe **nuk aksesojnë asnjë libër apo material shkencor në gjuhën shqipe.**
- Qeveria kishte parashikaur që brenda muajit Maj 2019 të krijojë Fondin e Solidaritetit për arsimin e lartë, ku 20 % e fondit të përgjegjësisë sociale të korporatave që gëzojnë kontrata koncesionare të shkojnë për financimin e Arsimit të Lartë, por ende **nuk ka asnjë shifër ose dokument publik që provon krijimin e Fondit të Solidaritetit.**
- Portali U-transparenca përmban të dhëna zyrtare mbi CV-të e pedagogëve dhe Anëtarëve të Bordeve por shfaq problematika në **zbardhjen e vendimeve të Bordeve, prokurimet publike dhe qartësinë e treguesve financiarë për studentët.**



VINI RE! Për lehtësi leximi dhe mirëinformimi mbi **Paktin për Universitetin raporti i dytë 3-mujor është integruar së bashku me raportin e parë 3-mujor të diferencuar me tekst më të vogël dhe më të zbehtë.**

Në fazën e parë të monitorimit ekspertët e Qëndresës Qytetare **kanë vlerësuar raportin mes kërkesave të studentëve dhe adresimeve të tyre në Paktin për Universitetin** dhe indikatorë matës kanë qënë:

- Niveli i realizimit të kërkesës
- Transparenca e procesve të parashikuara në Paktin për Universitetin.
- Retorika dhe komunikimin publik

Në fazën e dytë të monitorimit ekipi i Qëndresës **ka vlerësuar cilësinë, transparencën, territorin dhe kohën** e realizimit të premtimeve që parashikon Pakti për Universitetin ku indikator i kryesor matës ka qënë efektiviteti i realizimit të premtimit:

“Efektiviteti (effectiveness) është tregues me të cilin shprehet vlerësimi i ndikimit të një veprimi në një proces të caktuar apo thënë ndryshe niveli i realizimit të objektivave dhe marrëdhëniet ndërmjet rezultatit të pritur dhe rezultatit faktik të veprimtarisë.”

➤ **Kërkesa numër 1 e studentëve**

Kjo kërkesë është reflektuar pjesërisht në "Paktin për Universitetin" pasi qeveria nuk ndryshoi buxhetin për arsimin në raport me GDP, nuk përgjysmoi të gjitha tarifën duke aplikuar vlerësimin e përshkallëzimit meritokratik të studentëve dhe ndërhyrja në konvikte ka nisur vetëm për rezidencat që ndodhen në kryeqytet dhe jo në rrethe.

Kërkesa e parë e studentëve e monitoruar në **3 pjesë**:

Pjesa e parë

- **Kërkesa: (1) Rritje e buxhetit të arsimit në masën 5% e GDP me qëllim mundësimin e (2) përgjysmimit të tarifës së studimit për çdo nivel studimi, (3) përmirësimin e mësimdhënies dhe infrastrukturës.**
- **Statusi i kërkesës: E Refuzuar**

Kryeministri i vendit e ka refuzuar si të pa mundshme plotësimin e kësaj kërkesë duke mos e bërë pjesë të premtimeve të tij në "Paktin për Universitetin".

Buxheti për arsimin nuk u rrit në masën 5% të GDP, por mbeti i pandryshuar sipas miratimit të tij në Dhjetor 2018, me përjashtim tëndryshimit të miratuar financimit me 300.000 milion lekë të reja për rikonstruksionin e konvikteve nëpërmjet aktit normativ Nr. 2, datë 19.12.2018.

Fondet për "Sektorin e Arsimit" të parashikuara për vitin 2019, si pjesë e buxhetit për arsimin, në total arrijnë në vlerën e 57.8 miliardë lekë. Krahasuar me Produktin e Brendshëm Bruto, fondet për sektorin e arsimit parashikohet të arrijnë në 3.3% e PBB-së, por të ardhurat që alokohen për arsimin e lartë referuar edhe vitit 2018 shkojnë vetëm në 0.4 % të PBB-së.

Akordimi i grantit për reduktimin e pjesëshëm të tarifave të studentëve dhe dhënien e bursave në drejtim të IAL-ve është një veprim i paparashikuar në ligjin 80/2015 dhe nëse reduktimi do të vijojë në të njëjtën formë edhe vitin e ardhshëm do të duhet të shoqërohet me një proces të ndryshimit ligjor në kapitullin që i përket financimit të IAL-ve publike.

Pjesa e dytë

- **Kërkesa: Rritje e buxhetit të arsimit në masën 5% e GDP me qëllim mundësimin e përgjysmimit të tarifës së studimit për çdo nivel studimi, përmirësimin e mësimdhënies dhe infrastrukturës.**
- **Statusi i kërkesës: E Realizuar**

▪ Tarifat dhe Bursat

Nëpërmjet tri Vendimeve të Këshillit të Ministrave nr. 779, 780 dhe 784 datë 26.12.2018 qeveria realizoi një pjesë të kërkesës së parë të studentëve duke hequr tarifën e studimit për studentët me mesatare mbi 9, duke ofruar bursa për ta dhe duke përgjysmuar tarifën për studentët e tjerë të bachelor, vetëm për vitin 2018 – 2019. Po ashtu nëpërmejt këtyre VKM-ve qeveria reduktoi në masën 50% edhe tarifën e studentëve të ciklit master me mesatare mbi 9. Përgjysmimi i tarifave u arrit vetëm për kategori preferenciale sipas një skeme të ofruar nga qeveria, asaj të përshkallëzimit të tarifave bazuar në meritë, jo për të gjithë siç u kërkuar nga studentët. Efekti financiar nga buxheti i shtetit në total për reduktimin e tarifave dhe bursave në nivelin bachelor për vitin akademik 2018 – 2019 ishte 2.1 Miliardë lek ose i ndarë sipas kateogrive në tabelë:

Niveli i studimit	Masa e përfitimit	Kategoria e studentit përfitues	Numri i përfituesve	Efekt i financiar në buxhetin e shtetit
Bachelor	Përfundim 100% nga tarifa	Studentët me notë mesatare 9 deri 10	6,235 studentë	201.9 milionë lekë
Bachelor	Përfundim 50% nga tarifa	Studentët me notë mesatare nga 5 deri 9	70.000 studentë	1 miliardë lekë
Bachelor	Bursë 10.000 lekë/ muaj	Studentët me mesatare nga 9 deri në 10 dhe studentëve të familjeve përfitues të Ndihmës Ekonomike	8703 studentë	460 milionë lekë
Master	Reduktimi me 50% i tarifës së studimit	Studentët me notë mesatare 9 deri në 10	3311 studentë	150 milionë lekë
Master/ bachelor	Përgjysmim i tarifës së konvikteve të parestauruara	Të gjithë studentët e regjistruar në konvikte	8000 studentë	200 milion lekë
Totali			96.249	2.1 Miliard lekë

*Efekt i financiar në buxhetin e shtetit për përfituesit e kategorisë "studentë me notë mesatare nga 5 deri në 9 të nivelit të studimeve bachelor është vetëm për vitin 2019, pasi për vitin 2020 do të reduktohet për studentët me mesatare mbi 6.

Pjesa e tretë e kërkesës

Kërkesa: Rritje e buxhetit të arsimit në masën 5% e GDP me qëllim mundësimin e përgjysmimit të tarifës së studimit për çdo nivel studimi, **përmirësimin e mësimdhënies dhe infrastrukturës.**

Statusi i kërkesës: **Pjesërisht e Realizuar**

▪ Konviktet

Gjendja e infrastrukturës në konvikte është tejet e amortizuar pothuajse në Tiranë dhe në të gjitha ndërtesat në rrethe. Ndërtesat kanë nevojë urgjente për rehabilitim, pajisje me mobilie, shtretër, bazë materiale, dyshekë e çarçafë të rinj etj. Sipas raportit të Qëndresës Qytetare në muajin Shkurt 2018, 89 % e studentëve pohonin se tualetet e tyre ishin jashtë standarteve normale, ku kryesisht mungonin dyert, uji i rrjedhshëm dhe pajisjet e higjenes.²

Aktualisht, funksionojnë 8 shoqëri për akomodimin e studentëve, 3 prej të cilave janë në Tiranë dhe 5 të tjera në Vlorë, Shkodër, Elbasan, Gjirokastrë dhe Korçë.

Fondi që MASR ka në dispozicion, për të mbuluar shpenzimet operative për këto shoqëri, është 350 milionë lekë në vit, ndërsa pjesa tjetër mbulohet nga të ardhurat e vetë ndërmarrjeve të cilat sigurohen nga tarifat e akomodimit të studentëve.

Qeveria shqiptare nën presionin e protestës së studentëve u detyrua të nënshkruajë një marrëveshje granti me Bankën Gjermane për Zhvillim (KfE) për rikonstruksionin e konvikteve të studentëve në Tiranë sipas parimit të efikasitetit të energjisë në vlerën 18.8 milion euro.

Gjithashtu, përsëri në kuadër të Paktit për Universitetin qeveria u detyrua të ndryshojë buxhetin e shtetit për vitin 2019 nëpërmjet aktit normativ Nr. 2, datë 19.12.2018 duke alokuar edhe 300 milionë lekë të reja plus për rikonstruksionin e konvikteve.

²<http://qendresaqytetare.al/ep-content/uploads/2018/02/Analiza-e-pyetesorit-mbi-kushtet-Higjieno-Sanitare-ne-Qytetin-Studenti.pdf>

Infrastruktura dhe investimet në universitete nga qeveria:

Në kuadër të Paktit për Universitetin në një takim në UBT, kryeministri bëri publik një investim 1 milion euro për një fermë didaktike me një sipërfaqe prej 135 hektarë në kuadër të marrëveshjes mes Ministrisë së Bujqësisë dhe Universitetit Bujqësor të Tiranës më 15 Mars 2019.

Monitorimi Prill-Qershor 2019

Kjo periudhë monitorimi ka përkuar edhe me fushatën elektorale për zgjedhjet vendore ku Kryetari i Bashkisë Tiranë ka premtuar se **brenda mandatit të tij të dytë do të ndërtojë Kampusin Universitar**, i cili do të përbëhet nga **11 godina të reja në Qytetin Studenti** si dhe ambiente të reja leximi e studimi.³

Ndërhyrja në 16 godinat e konvikteve deri në muajin Qershor 2019 ka qënë në fasada dhe korridore dhe **është premtuar që gjatë verës do të ndërhyhet në dhomat e studentëve**, kohë kjo që përkon me boshatisjen e konvikteve për shkak të përfundimit të vitit akademik.

Ndërkohë asnjë investim nuk është parashikuar gjatë këtij viti për konviktet e bashkive të tjera universitare (Elbasan, Shkodër, Korçë, Vlorë dhe Gjirokastër), të cilat kanë trashëguar një situatë më të rëndë dhe mungesë investimesh më të gjatë në kohë se konviktet e kryeqytetit ndër vite.

RESTAURIMI I KONVIKTEVE		
Treguesit	Rezultati	Shpjegimi
EFEKTIVITETI	DISI EFEKTIV	Procesi ka nisur në vetëm 16 nga 26 godina në QS, restaurimi ka prekur vetëm pjesën e fasadës dhe korridoreve por jo hapësirat e dhomave.
TRANSPARENCA	JO TRANSPARENT	Nuk u bënë publike shpenzimet e fondeve të KFW dhe buxhetit të shtetit në raport me ndryshimin real që pësuan godinat e konvikteve.
TERRITORI I REALIZIMIT	LOKAL	Efekti i këtij premtimi u shtri vetëm në kryeqytet, pasi për konviktet e rretheve nuk apti asnje projekt apo investim.
KOHA E REALIZIMIT	BRENDA AFATIT	Duhet të mbarojë restaurimi I të gjitha godinave në fillim të viti akademik 2019 – 2020.

³ <https://ëëë.tirana.al/artikull/qeveria-dhe-bashkia-e-tiranes-prezantojne-projektin-e-ri-te-kampusit-universitar>

➤ Kërkesa numër 2 e studentëve

Monitorimi Janar-Mars

- **Kërkesa:** *Transparencë me buxhetin nga MASR dhe IAL-të, publikim i të gjitha shpenzimeve online.*
- *Statusi i kërkesës: **E realizuar pjesërisht***

Nisur nga kjo kërkesë e studentëve por edhe nga gjetjet e monitorimit të Qëndresës gjatë vitit akademik 2017 – 2018 ku paratë e studentëve shkuan për shpenzime luksi për rektorët, makina dhe kontrata të fryra të ruajtjes së godinave dhe jo për shkencë dhe shërbime ndaj studentëve, qeveria e adresoi këtë kërkesënë **“Paktin për Universitetin”** duke premtuar krijimin e një strukture në MASR, përgjegjëse për kontrollin e transparencës në arsimin e lartë dhe portalit **U-transparenca** me të dhëna të detajuara mbi shpenzimet e universiteteve dhe mundësi ankimi nga studentët.


Monitorimi Prill-Qershor 2019

Referuar VKM 781/2018 në fillim të muajit Prill 2019 u krijua portali **u-transparenca.al** i cili përmban të dhëna për CV-të e pedagogëve të pjesës dërmuese të universiteteve publike, të dhëna mbi emrat dhe CV-të e Anëtarëve të Bordit të Adminsitrimt të emëruar nga MASR dhe informacion mbi të ardhurat dhe shpenzimet e universiteteve në raporte 3 – mujore.

PORTALI I TRANSPARENCËS		
Treguesit	Rezultati	Shpjegimi
EFEKTIVITETI	DISI EFEKTIV	Përmban të dhëna zyrtare mbi CV e pedagogëve, Anëtarëve të Bordeve por shfaq problematika në vendimet e Bordeve, prokurimet publike dhe qartësinë e treguesve financiarë për studentët.
TRANSPARENCA	TRANSPARENT	-
TERRITORI I REALIZIMIT	KOMBËTAR	-
KOHA E REALIZIMIT	BRENDA AFATIT	-

Aktualisht portali shfaq problematika dhe mungesa në:

- Publikimin e vendimeve të zbardhura të Bordeve të Administrimit të IAL-ve.
- Dokumentacionin e prokurimeve publike të universiteteve (Tendera, kontrata, kërkesa, oferta dhe detaje të tjera).
- Paqartësinë e publikimit të treguesve financiarë mbi të ardhurat dhe shpenzimet e universiteteve.



➤ Kërkesa numër 3 e studenteve

➤ Monitorimi Janar-Mars 2019

- **Kërkesa:** Rritje e peshës së votës të studentëve nga 10% në 50% në zgjedhjet për strukturat akademike.
- *Statusi i kërkesës: **E refuzuar***

Në dokumentin e Paktit për Universitetin qeveria ka argumentuar refuzimin e kësaj kërkesë duke parashtruar shembujt e vendeve të tjera të Evropës dhe Rajonit të cilat nuk e kanë peshën e studentëve në zgjedhjet për strukturat akademike më të lartë se 20 %. Por në këtë aspekt nuk është marrë parasysh tradita ligjore e ligjit për arsimin e lartë të vitit 2007, ku pesha e votës së studentëve ka qënë në masën 20%, ndryshim i cili mund të inkorporohej edhe në ligjin aktual 80/2015.

Në 30 Janar 2019 deputetë të Lëvizjes Socialiste për Integrim prezantuan një iniciativë ligjore në Komisionin Parlamentar të Edukimit dhe Mjeteve të Informimit Publik për të ndryshuar peshën e votës së studentëve nga 10% në 50%, nismë e cila i përgjigjej kërkesës së studentëve. Kjo iniciativë nuk u mirëprit nga mazhoranca dhe Pakti për Universitetin nuk parashikon asnjë ndryshim ligjor për rritjen e peshës së votës së studentëve në zgjedhjet e organeve akademike brenda universitetit. Si rrjedhim kjo kërkesë nuk u adresua në "Paktin për Universitetin".

➤ Kërkesa numër 4 e studenteve

➤ Monitorimi Janar-Mars 2019

- **Kërkesa:** Bordi i Administrimit të ketë numër të barabartë anëtarësh nga IAL dhe MASR dhe një përfaqësues në këtë bord të jetë nga studentët.
- **Statusi i kërkesës: Pjesërisht e realizuar**

Sipas Ligjit për Arsimin e lartë, Bordet e Administrimit përbëhen nga shtatë anëtarë, të punësuar me kohë të pjesshme. Anëtarët, përfaqësues të IAL-së, përzgjidhen nga Senati Akademik i IAL-së. Anëtarët përfaqësues të Ministrisë përgjegjëse për Arsimin dhe njësisë së qeverisjes vendore janë ekspertë të njohur nga fushat akademike, menaxheriale, ekonomike dhe juridike dhe emërohen përkatësisht nga ministri përgjegjës për Arsimin dhe kryetari i njësisë së qeverisjes vendore. Përbërja e Bordit të Administrimit përcaktohet në varësi të Planit Buxhetor Afatmesëm të Institucionit publik të Arsimit të Lartë. Nëse institucioni siguron vetë pesëdhjetë për qind (50%), ose më shumë të buxhetit afatmesëm, katër prej anëtarëve janë përfaqësues të IAL-së dhe tre janë përfaqësues të Ministrisë përgjegjëse për Arsimin. Në rastet kur institucioni siguron vetë më pak se pesëdhjetë për qind të buxhetit afatmesëm, tre prej anëtarëve janë përfaqësues të IAL-së dhe katër janë përfaqësues të Ministrisë përgjegjëse për Arsimin. Sot, nga gjithë IAL-të publike, vetëm Universiteti i Tiranës ka një shumicë nga përfaqësues të Universitetit.

Më 26.12.2018 u miratua Vendimi nr. 782 i Këshillit të Ministrave **“Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit, përfaqësues të Ministrisë përgjegjëse për Arsimin, në Institucionet publike të Arsimit të Lartë”**. Si rezultat i kësaj VKM-je:

- **Zvendësohen** të gjithë Anëtarët e Bordeve të emëruar nga MASR.
- **Emërimet** e reja do të bëhen më një *proces të hapur dhe me vëmendje publike*.
- **Njëri prej anëtarëve** që emërohet prej MASR, të vijë propozim nga studentët, por të jetë figurë publike në përputhje me ligjin.

Referuar këtij akti nënligjor në 9 Shkurt 2019 MASR shpalli konkursin për Anëtarët e Bordit, përfaqësues të Ministrisë dhe studentëve por për shkaqe ende të pa bëra publike ky proces u shty tri herë për ri-aplikim dhe zgjati rreth 1 muaj e gjysëm deri në plotësimin e plotë të vakancave në borde, respektivisht në datën 26 Mars 2019. Ajo që bie në sy nga publikimi i listës së anëtarëve të Bordeve të Administrimit të emëruar nga MASR është se vetëm në 3 nga 12 Universitete u emëruan përfaqësuesit e studentëve, ndërsa anëtarët e emëruar nga MASR nuk rezultojnë të jenë figura publike siç është parashikuar në VKM.

Monitorimi Prill-Qershor 2019

Gjatë periudhës së monitorimit u zhvilluan disa procese të rëndësishme në lidhje me rikompozimin e Bordeve të reja të Administrimit duke emëruar dhe zgjedhur anëtarët nga MASR dhe anëtarët e zgjedhur nga vetë studentët në pjesën dërmuese të universiteteve publike.

RIKOMPOZIMI I BORDEVE TË ADMINISTRIMIT

Treguesit	Rezultati	Shpjegimi
EFEKTIVITETI	JO EFEKTIV	Votat e studenteve nuk ishin gjithmonë përcaktuese, mungoi rregullorja specifike dhe kandidaturat përgjithësisht ishin jashtë kritereve të VKM-së 782.
TRANSPARENCA	JO TRANSPARENT	Nuk u publikuan votat e të gjitha proceseve zgjedhore, CV-të e kandidatëve dhe arsytet e përzgjedhejs së tyre nga MASR.
TERRITORI I REALIZIMIT	KOMBËTAR	Efekti i këtij premtimi u shtri në të gjithë territorin e Shqipërisë.
KOHA E REALIZIMIT	JASHTË AFATIT	Sipas afateve të parashikuara në Paktin për Universitetin ky proces duhet të mbaronte brenda muajit Mars 2019, por ende nuk ka përfunduar.

Procesi i emërimit të Anëtarëve të Bordeve të Administrimit nga MASR

Pas zëvendësimit të 35 anëtarëve të Bordeve të Administrimit, përfaqësues të MASR vihet re se një pjesë e madhe e tyre vijnë si zyrtarë të administratës publike përkatësisht 18 prej tyre, 8 vijnë nga fusha akademike, 6 vijnë nga shoqëria civile dhe sektori privat dhe 3 vijnë nga fusha e gazetarisë.

Pavarësisht se Anëtarët e Bordit sipas qeverisë u riformatuan për të vendosur në to figura publike dhe për t'i dhënë mundësi studentëve të votonin një përfaqësues të zgjedhur prej tyre. Nuk ka munguar presioni dhe denoncimi nga studentët, akademikët⁴ dhe shoqëria civile⁵ mbi keq-menaxhimin dhe konfliktin e interesit të Anëtarëve të rinj të Bordit, të cilët kryesisht ishin zyrtarë të lartë të administratës publike. Pra sërish MASR ka qëndruar tek formati i zyrtarëve të shtetit për tu përfaqësuar në borde.

Megjithëse një nga kriteret që duhet të përmbushnin të zgjedhurit në borde ishte të qenurit figurë publike, sipas monitorimit të Qëndresës Qytetare vetëm 13 nga 35 anëtarët e rinj të emëruar nga MASR janë figura publike. Pra 22 të emëruar në borde janë persona me profil të ulët sa i përket prezencës dhe informacionit që gjendet për ta në publik (përfundim I nxjerrë edhe nga konsultimet me studentët dhe monitorimi i publikimeve apo prezences në media i këtyre individëve).

⁴ <https://urbanlajme.com/2018/12/09/artan-fuga-ndez-protesten-e-studenteve-ja-cfare-paralajmeron-per-ne-mbremje/>

⁵ <https://www.facebook.com/qendreseqytetare/photos/a.1730930620466161/2701041240121756/?type=3&theater>

Procesi i përzgjedhjes së Anëtarëve të Bordeve të Administrimit nga studentët

Procesi për të zgjedhur Anëtarët e Bordeve të Administrimit nga studentët si përfaqësues të MASR ka përfunduar vetëm në 8 nga 12 universitete. Në Universitetin Politeknik të Tiranës procesi u anulua me urdhër të MASR për shkak se kandidatura e përzgjedhur nga studentët ishte në konflikt interesi pasi i përkiste stafit akademik të UPT, në Universitetin e Tiranës fitues nga votat e studentëve u shpall Llesh Lleshaj por kjo kandidaturë ende nuk është emëruar nga MASR, ndërsa në 3 universitete të tjera procesi vijon të mos prodhojë Anëtarë Bordi nga votat e studentëve për mungesë apo tërheqje të kandidaturave.

Përbërja e Bordeve të reja	Administrata publike	Pedagogë	Gazetarë	Sh.civile/ S.Privat	Në proces	Total	Figura publike
<i>Anëtar Bordi i emëruar nga MASR</i>	18	8	3	6	0	35	13
<i>Anëtar Bordi i votuar nga Studentët</i>	3	1	2	2	4	12	2

Si rezultat i këtyre ndryshimeve mund të themi se:

*Kryeministri zëvendësoi anëtarët e Bordeve të Administrimit por sërish u emëruan zyrtarë të qeverisë, persona larg botës akademike, ish politikanë ose përfaqësues të posteve politike. Si rrjedhim me zvendësimin e bordeve nuk pati ndryshim elitash dhe frymë por vetëm ndryshim emrash. Gjithashtu **administratorët që janë personat e lidhur drejtpërdrejt me menaxhimin e parave të studentëve vazhdojnë të jenë në detyrë.**

*Studentët kërkuan që një prej anëtarëve të Bordit të Administrimit të jetë student, ndërsa **MASR ofroi që një prej tyre të votohet nga studentët.**


*Procesi i zgjedhjes nga studentët i anëtarëve përfaqësues të MASR **tejkaloj afatet e parashikaura** sipas Paktit për Universitetin. Megjithëse procesi duhet të mbaronte në muajin mars 2019, edhe deri në 30 Qershor 2019 nuk përfundoi tërësisht.

*Votimet e studentëve për anëtarët e Bordeve të Administritimit u shoqëruan me **mungesë transparence dhe pjesëmarrje**. Në universitetin më të madh në Shqipëri atë të Tiranës morën pjesë vetëm 11% e studentëve në votime për Bordet e Administritimit.

***Mungesa e rregullores specifike** mbi procesin e votimeve për anëtarë bordi solli cënim të së drejtës së votës, pasi MASR i përzgjodhi kandidatët jo në bazë të votave por në bazë të kodit të procedurave administrative ku titullari, në këtë rast Ministri i Arsimit ka të drejtë të zgjedhë një nga 3 kandidaturat pavarësisht numrit të votave që ka grumbulluar ajo kandidaturë.

Për ta ilustruar edhe vënë në dukje këtë problematikë do t'i referohemi votimeve të realizuara në Universitetin "Fan Noli" në Korçë, ku Minsitrija e Arsimit urdhëroi emërimin e kandidatit "Artur Balli" duke cënuar demokracinë dhe vullnetin e votive të studentëve, shumica e të cilëve votoi për kandidaten "Kostanca Doku".

Rezultati i zgjedhjeve për anëtar të Bordit të Administritimit në Universitetin e Korçës.


 REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 UNIVERSITETI "FAN S. NOLI" KORÇË
 KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

Nr. 933 Prot. Korçë më 16.05.2019

VENDIM Nr. 249

Në zbatim të rregullores nr. 2459/1, datë 15.03.2016 "Për organizimin e zgjedhjeve të para për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", si dhe VKM Nr. 782, datë 26.12.2018, "Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të përgjigjes së anëtarëve të bordit të administritimit, përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin, në institucionet publike të arsimit të lartë", Komisioni Institucional Zgjedhor pasi mori vendimet për rezultatet e KZF-ve dhe bëri mbledhjen e votave

VENDOSI:


1- Të shpallë rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për anëtar të bordit të administritimit që votohet nga studentët:

ALBENS TABAKU	153 VOTA
ARTUR BALLI	259 VOTA
KOSTANCA DOKU	313 VOTA
LORENC BELLOVODA	219 VOTA
MAKSIM FEZULLA	195 VOTA

2- Në bazë të rezultateve Komisioni Institucional Zgjedhor shpall Fitues kandidatët:

- ARTUR PANDI BALLI
- KOSTANCA GAQO DOKU
- LORENC KRISTAQ BELLOVODA

1081
14.06.2019


 REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
 MINISTRI

5984 Prot. Tiranë, më 07.06.2019

URDHËR

Nr. 328, datë 07.06.2019


PËR
DISA NDRYSHIME NË URDHRIN NR. 162, DATË 13.03.2019
"PËR LIRIMIN NGA DETYRA TË ANËTARËVE TË BORDIT
TË ADMINISTRIMIT TË UNIVERSITETIT "FAN S. NOLI", KORÇË
DHE EMËRIMIN NË DETYRË TË ANËTARËVE TË RINI, PËRFAQËSUES TË
MINISTRISË PËRGJEGJËSE PËR ARSIMIN"

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutit të Republikës së Shqipërisë, të neneve 48, 49 dhe 50 të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe Vendimit nr. 782, datë 26.12.2018 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të përgjigjes së anëtarëve të Bordit të Administritimit, përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin, në institucionet publike të arsimit të lartë".

URDHËROJ:

- Në pikën 2 të urdhrin, nr. 162, datë 13.03.2019, të shtohet shkronja "q", si më poshtë:
" ç) Artur Balli"
- Pika 3 e urdhrin, nr. 162, datë 13.03.2019, shfuqizohet.
- Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Universiteti "Fan S. Noli", Korçë dhe anëtarët e Bordit të Administritimit.

si fuqi menjëherë.


 Bleda SHAHIN
 MINISTRI

Urdhëri u Ministres për emërimin e z. Artur Balli si anëtar të Bordit të Administritimit në U. "Fan Noli"

Nr.	IAL	Anëtarët e bordit të administritimit zgjedhur nga studentët
1	Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër	Ted Paco
2	Universiteti Bujqësor i Tiranës	Marin Mema
3	Universiteti "Eqerem Çabej" Gjirokastrë	Erjon Nebiaj
4	Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	Anjeza Shiko
5	Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	Etleva Leskaj
6	Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan	Luan Rapi
7	Universiteti "Fan Noli" Korçë	Artur Balli
8	Universiteti i Arteve	Bujar Kapexhiu

Lista me anëtarët e Bordit të Administritimit të votuar nga studentët deri në muajin qershor 2019

Pjesëmarrja në votime për Anëtar Bordi në universitete ishte relativisht e ulët, ku vlen të theksojmë rastin në Fakultetin e Gjeologji Minerave morën pjesë në votime vetëm 55 studentë nga 2500 ose vetëm 2.2% e studentëve. Arsyet e mospjesëmarrjes lidhen me mungesën e besimit të procesit, mungesën e informimit paraprak dhe rëndësisë që kanë anëtarët e bordit në administrimin e parave të universitetit.

REZULTATI I NUMERIMIT - FAKULTETI I GJELOGJISE DHE MINIERAVE **FGJM**

NUMRI I PËRGJITHSHËM I VOTAVE TË VLEFSHME: **55**

REZULTATET E KANDIDATËVE PËR ANËTAR TË BORDIT TË ADMINISTRIMIT

9 MAJ 2019

Nr.	Emri	Atësia	Mbledhri	Vota	Përqindja
1	ELED	EDMOND	FAGU	0	0%
2	ESMERALD	ENVER	FILAJ	4	7.272%
3	LORETA	SIMON	CAPELI	4	7.272%
4	RIKARD	VIKTOR	LUKA	22	40%
5	ZENEL	GJOLEK	SHALARI	25	45.45%

Vota totale	Vota të vlefshme	55
	Vota të pavlefshme	4
	Fletë të dëmtuara	1
	Fletë të papërdorura	2440
	Fletë votimi në total	2500

Shënim: Kjo tabelë hartohet në 3 kopje. 1 kopje futet në kuti së bashku me rezultatin dhe 1 mbahet nga KZF dhe 1 kopje dorëzohet në KZ.

Anëtarët e KZF (firma):

- Arben Bakiri (PRO) *Bakiri*
- Altin Kallipi (PRO) *Kallipi*
- Duljan Begiraj (PRO) *Begiraj*
- Femerida Zega (PRO) *Zega*
- Kevin Kucaj (student) *Kucaj*

Universitetet në të cilat nuk është zgjedhur ende anëtari i Bordit të Administrimit nga votat e studentëve.

	UNIVERSITETI	ARSYET
9	Universiteti i Tiranës	Procesi i votimeve ka përfunduar por Ministrija nuk ka emëruar asnjë nga 3 kandidatët fitues.
10	Universiteti Politeknik i Tiranës	Procesi i votimeve ka përfunduar por Ministrija nxorri urdhër për anulimin e tij pasi kandidati fitues ishte në konflikt interesi me detyrën.
11	Universiteti i Mjekësisë	Nuk ka transparencë dhe infoamcion mbi procesin
12	Universiteti i Sporteve	Nuk ka transparencë dhe infoamcion mbi procesin

➤ Kërkesa numër 5 e studentëve

➤ Monitorimi Janar-Mars 2019

- **Kërkesa:** Pajisja e të gjithë studentëve me Kartën e Studentit brenda vitit akademik 2018 – 2019
- **Statusi i kërkesës: Pjesërisht e Realizuar**

Sipas premtimit në "Paktin për Universitetin" Karta e Studentit do të jetë pjesë e projektit të Kartës Europiane të Studentit dhe do të lëshohet nga Qendra e Shërbimeve Arsimore. MASR do të bëjë publike marrëveshjet e lidhura dhe listën e shërbimeve që përfitohen nga studentët me entet shtetërore, bashkitë dhe subjektet private duke përcaktuar shërbime me çmime të reduktuara për studentët në të gjithë vendin dhe për studentët e huaj në Shqipëri.

- a) Sipas Paktit për Universitetin **Brenda muajit shkurt** duhet të ishin miratuar dy akte nënligjore VKM dhe Udhëzim i Ministrit të Arsimit për jetësimin e projektit të Kartës së Studentit. Megjithëse ka kaluar një muaj nga ky afat dhe ende nuk kemi publike këto akte.
- b) Marrëveshja mes CNOUS dhe Qendrës së Shërbimeve Arsimore synon realizimin e një karte studentit të paparashikuar në ligjin 80/2015, kartë e cila është krijuar nga disa DJF dhe një projekt i Komisionit Europian. Ky është një tjetër devijim ligjor nga ai i parashikuar në nenin 100 të ligjit 80/2015, devijim që rrezikon tëservirë përsëri një kartë elektorale studentit sesa përmbushjen e një detyrimi ligjor.



Monitorimi Prill-Qershor 2019

Sipas ligjit 80/2015 për arsimin e lartë Karta e Studentit është një dokument unik dhe përgjegjësi i vetëm për prodhimin dhe lëshimin e saj është Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Më 17 Prill 2019 u publikua në fletoren zyrtare vendimi i qeverisë nr. 226 për shërbimet që do të ofrojnë institucionet në kuadër të kartës së studentit. Ky vendim në pikën 11 të tij parashikon edhe një mundësi që përveç MASR, kartën e studentit mund ta prodhojnë dhe administrojnë me fondet e tyre edhe njësitë e vetqeverisjes vendore.

Me publikimin e këtij vendimi, bashkia Tiranë nisi menjëherë prodhimin dhe shpërndarjen e kartës së studentit në universitete.

KARTA E STUDENTIT

Treguesit	Rezultati	Shpjegimi
EFEKTIVITETI	DISI EFEKTIV	Nuk ofron zbritje për shërbime dhe produkte bazike dhe të nevojshme për studentët (ushqim, kancelari, library, telefon, internet apo transport). MASR ka ne dispozicion 0 lek buxhet për vitin 2019 për Kartën e Studentit.
TRANSPARENCA	JO TRANSPARENT	Nuk ka informacion publik në lidhje me tenderin e prodhimit të kartës, marrëveshjet mes institucioneve dhe nuk është bërë publike asnjë marrëveshje me operatorët privatë, nuk është publikua sasinë e buxhetit për cmimet e reduktuara nga bashkia Tiranë.
TERRITORI I REALIZIMIT	LOKAL	Karta e studentit vijon të shpërndahet vetëm tek studentët në kryeqytet dhe jo në ata në bashkitë e tjera universitare.
KOHA E REALIZIMIT	JASHTË AFATIT	Sipas Paktit për Universitetin Karta e Studentit duhet të ishte realizuar Brenda vitit akademik 208 – 2019.

Deri në fillim të muajit Korrik 2019 janë shpërndarë rreth 20.000 Karta Studenti në kryeqytet nga bashkia Tiranë. Karta e prodhuar nga bashkia përmban 40 shërbime të miratuara nga Këshilli Bashkiak duke ofruar ulje për vizitat në muze, teatër e kinema por duke anashkaluar nevojat bazike të tyre si ushqimi, veshja, kancelaritë, librat, spitalet dhe komunikacioni.⁶ Bashkia Tiranë premtoi se me kartën e studentit do të përfitohej aboneja e përgjithshme me çmim 600 lek, por deri në fund të muajit Qershor 2019 operatorët e transportit nuk e lëshonin këtë dokument për studentët.

Skema që parashikon VKM 226 për prodhimin e 6 kartave të studentit sipas bashkive universitare bie në kundërshtim me nenin 100 të ligjit të arsimit të lartë i cili e cilëson Kartën e Studentit si një dokument unik që prodhohet, administrohet dhe shpërndahet nga MASR. Kjo skemë ka sjellë implementimin e një kartë lokale student dhe rrezikun e përdorimit të të dhënave personale të studentëve nga bashkitë.

Sipas Komunikimit zyrtar mes Qëndresës Qytetare dhe MASR, buxheti në dispozicion të Kartës së Studentit nga kjo ministri është 0 lek. Sipas përgjigjes zyrtare kostot do të përballohen nga njësitë e qeverisjes vendore.

⁶ <http://top-channel.tv/2019/04/16/karta-e-studentit-40-sherbime-lehtesira-edhe-nga-kompani-private/>

➤ Kërkesa numër 6 e studenteve

➤ Monitorimi Janar-Mars 2019

- **Kërkesa:** Rishikimi i titujve akademikë dhe verifikimi i plagjiaturave të doktoraturave dhe teksteve mësimore.
- **Statusi i kërkesës: E perealizuar**

Më 26.12.2018 u miratua Vendimi nr.777 i Këshillit të Ministrave **“Për kontrollin anti-plagjaturë të disertacioneve për fitimin e gradave shkencore”**. Kjo VKM ndër të tjera parashikon krijimin e arkivit digjital të doktoraturave në Republikën e Shqipërisë pranë MASR dhe pasi të kryhet kontrolli i të gjitha gradave shkencore të akumuluar në këtë arkiv nëpërmjet një programi soft, ministria përgjegjëse për arsimin do të dorëzojë raportet e kontrollit digjital anti-plagjaturë pranë IAL-ve respektive për të vlerësuar dhe marrë masat respektive për titujt me probleme me plagjiaturën.

Referuar afateve të “Paktit për Universitetin” duhet që brenda muajit Qershor 2019 të:

Kryhet kontrolli Anti-plagjaturë dhe rishikimi i titujve akademikë.
Krijohet Arkivitet Digjital i doktoraturave në Republikën e Shqipërisë pranë MASR.
Të miratohet ligji i ri për Kodin e Sjelljes dhe integritetin në kërkimin shkencor.

Nga viti 2007 deri në vitin 2018, në regjistrin e MASR gjenden vetëm këto të dhëna në lidhje me gradat shkencore dhe titujt akademikë:

- 248 Docent
- 3,757 Grada Shkencore “Doktor” brenda vendit
- 546 Grada Shkencore “Doktor” jashtë vendit
- 1,038 Tituj Akademikë “Profesor i Asociuar”
- 2 Tituj Akademikë “Profesor i Asociuar” jashtë vendit
- 503 Tituj Akademikë “Profesor”


Monitorimi Prill-Qershor 2019

Nisur nga premtimi i qeverisë në dokumentin e “Paktit për Universitetin” se **brenda muajit Qershor 2019 do të ketë nisur rishikimi i titujve akademikë, kontrolli anti-plagjiaturë** dhe krijimi i Arkivitet Digjital të doktoraturave rezulton si një premtim i pa mbajtur në afat sipas parashikimeve të vetë qeverisë. Nga komunikimi zyrtar mes Qëndresës Qytetare dhe MASR në muajin prill në funksion të Arkivitet Digjital numri i disertacioneve të depozituara ishte 12, ndërsa në komunikimin në fund të muajit Qershor 2019 ministria është përgjigjur *“informojmë se MASR është në proces për ngritjen e Arkivitet digjital në bashkëpunim me AKSHI”*.

RISHIKIMI I TITUJVE AKADEMIKË/ KONTROLLI ANTI-PLAGJIATURË

Treguesit	Rezultati	Shpjegimi
EFEKTIVITETI	-	Asnjë titull shkencor në periudhën Janar – Qershor 2019 nuk është kontrolluar për plagjiaturë, nuk është ngritur arkivi digjital dhe 0 raportim/ndëshkim pavarësisht kërkesave dhe ankesave të studentëve.
TRANSPARENCA	JO TRANSPARENT	Procesi nuk është publik sa i përket ecurisë, nuk është shoqëruar me retorikë mediatike si premtimet e tjera dhe nuk ka asnjë dokument publik që fakton se ky premtim po realizohet.
TERRITORI I REALIZIMIT	-	-
KOHA E REALIZIMIT	JASHTË AFATIT	Sipas Paktit për Universitetin ky premtim duhet të ishte realizuar deri në muajin Qershor 2019.

Ndërkohë MASR ka përgatitur një projektligj në 26 Dhjetor 2019 për Kodin e sjelljes për integritet në kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë i cili parashikon gjoba për shkelësit e integritetit shkencor nga 1 – 3 milion lekë, por edhe ky ligj nuk është kaluar në axhendën parlamentare për tu miratuar.



➤ Kërkesa numër 7 e studentëve

➤ Monitorimi Janar-Mars 2019

- **Kërkesa:** Vlerësim i performancës në mësimdhënie dhe kërkimi shkencor, publikimet online dhe regjistrimi/filmimi i leksioneve.
- **Statusi i kërkesës: Pjesërisht e realizuar**

Protesta e studentëve dhe monitorimet e Qëndresës Qytetare gjatë vitit 2018 ekspozuan nivelin e lartë të perceptimit të korrupsionit në universitetet publike dhe problematika të tjera të stafit akademik si performance jocilësore, kualifikimet fiktive, rekrutimet pa meritë të stafit akademik, kurrikula jo bashkëkohore dhe vlerësime fiktive të performancës nga vetë universitetet.

Pakti për Universitetin e adresoi këtë problematikë duke parashikuar aplikimin e instrumentit të kontrollit dhe vlerësimit studentor të performancës së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor të personelit akademik përmes Sondazhit Kombëtar të Studentëve (SKS). Raportet e vlerësimit të përgatitura nga ASCAL do t'i paraqiten Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, krahas Institucionit të Arsimit të Lartë që i është nënshtruar procesit të vlerësimit, si dhe duhet të jenë pjesë e **dosjes personale** të çdo anëtari të personelit akademik.

1. Referuar Pakti për Universitetin, **brenda muajit Shkurt 2019** duhet të ishin ngritur grupet e punës me pjesëmarrjen edhe të studentëve në procesin e vlerësimit (SKS), **fakt që ende nuk është bërë publik.**
2. Hartimi i metodologjisë dhe pyetësorit të SKS duhet të kishte ndodhur **brenda muajit Mars 2019**, por përsëri nuk kemi asnjë publikim apo akt të nxjerrë brenda muajit Mars 2019.
3. Realizimi i Sondazhit Kombëtar të Studentëve dhe krijimi i dosjeve personale të pedagogëve – Qershor 2019
4. Hartimi i Kodit të Cilësisë në Arsim duke përfshirë shqetësimet e studentëve – Qershor 2019

Monitorimi Prill-Qershor 2019

Për të adresuar problematikat e evidentuara gjatë protestës së studentëve dhe sipas parashikimeve në "Paktin për Universitetin" MASR realizoi Sondazhin Kombëtar të Studentëve në muajt prill – maj 2019. Pyetësi u hartua nga bordi i akreditimit i përbërë nga 11 profesorë dhe ju shpërnda rreth 100.000 studentëve në e-mail-et e tyre, ku pjesëmarrja e tyre ishte në masën 20%.

SONDAZHI KOMBËTAR I STUDENTËVE

Treguesit	Rezultati	Shpjegimi
EFEKTIVITETI	JO EFEKTIV	Studentët nuk morën pjesë në grupin e punës së sondazhit. Nuk u adresuan rastet e korrupsionit, nuk u krijuan dosje personale për pedagogët sipas parashikimit fillestar.
TRANSPARENCA	JO TRANSPARENT	Nuk janë bërë publike rezultatet e SKS. Nuk pati fushatë të gjerë ndërgjegjësuere. Pjesës dërmuese të studentëve pyetësoni i mbërriti në rubrikën spam të e-mailit jo në inbox.
TERRITORI I REALIZIMIT	KOMBËTAR	-
KOHA E REALIZIMIT	JASHTË AFATIT	Procesi duhet të kishte përfunduar në 2 maj 2019 ndërkohë që tejkaloi afatet e realizimit dhe publikimit.

Përtej problematikave me vonesat dhe mospërfshirjen e studentëve në hartimin e pyetësorit të sondazhit ky proces anashkaloi dy zotimet kryesore që synonte të adresonte ndaj studentëve që ishin trajtimi i fenomenit të korrupsionit në universitete dhe krijimi i dosjeve të pedagogëve sipas vlerësimit në këtë sondazh. Pavarësisht se rezultatet e Sondazhit nuk janë bërë ende publike, studentët në pyetësor nuk kanë pasur mundësi të shprehen në asnjë pyetje për raste individuale të korrupsionit pasiv, të mungesës së etikës në mësimdhënie dhe të vlerësojnë pedagogët në mënyrë që në bazë të rezultateve të krijohen dosjet e tyre personale.

https://ascal.al/sq/sondazhi-kombetar-i-studenteve/rezultatet-e-vleresimit

Programi i Transparencës | Procesi i akreditimit QAA | Na kontaktoni

ascal Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë

KREU RRETH NESH BORDI I AKREDITIMIT AKREDITIMI SIGURIMI I CILËSISË SONDAZHI KOMBËTAR I STUDENTËVE INFORMACIONE

Je ketu: / SONDAZHI KOMBËTAR I STUDENTËVE / Rezultatet e SKS 2019

SKS Rezultatet e Vlerësimit

- Metodologjia dhe instrumentat
- Takimet informuese
- Rezultatet e Vlerësimit

➤ Kërkesa numër 8 e Studentëve

➤ Monitorimi Janar-Mars 2019

- **Kërkesa:** Ndërtimi i bibliotekave me standarte Evropiane dhe me libër universitar online falas për studentët në gjuhën shqipe.
- Statusi i kërkesës: **E porealizuar**

Për shkak të kostos së lartë të çmimeve të librave dhe mungesës së aksesit të studentëve në botime shkencore për realizimin e detyrave të kursit dhe kërkimit shkencor brenda IAL-ve, ndërtimi i një biblioteke online me standarte Evropiane ishte një ndër kërkesat e studentëve.

- Sipas Paktit për Universitetin, kjo kërkesë është adresuar nëpërmjet premtimit për ngritjen e bibliotekës digjitale për studentët Brenda **muajit Mars 2019**. Aktualisht qeveria **ka deklaruar se ka nënshkruar** një kontratë për të blerë të drejtën e aksesit në një bibliotekë elektronike për një periudhë 3-vjeçare por ende kjo bibliotekë nuk është e aksesueshme nga studentët, si dhe procedurat e tenderimit, blerjes dhe kontratës janë në mungesë të plotë transparence.
- Ndërsa ngritja e grupit të punës për përzgjedhjen e literaturës së huaj që do të përkthehet me Urdhër të Kryeministrit do të realizohet deri në Qershor 2019.

Monitorimi Prill-Qershor 2019

Në muajin Prill u prezantua nga Kryeministri dhe ministrja e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Biblioteka Digjitale si një nga premtimet e “Paktit për Universitetin” që do të adresonte problematikën e kostove të blerjes së librave dhe do të rriste aksesin e studentëve në botime shkencore. Sipas përfaqësuesve të qeverisë kjo bibliotekë krijon akses ndaj kërkuesve shkencorë në 50 mijë revista shkencore, 193 mijë libra akademikë dhe 30 module për të mësuar vetë në gjuhë të huaj. Cdo student apo pedagog mund ta aksesojë bibliotekën online përmes një llogarie unike dhe një fjalëkalimi.

BIBLIOTEKA DIGJITALE		
Treguesit	Rezultati	Shpjegimi
EFEKTIVITETI	DISI EFEKTIV	Biblioteka digjitale nuk u shërben studentëve në raport me kurrikulat mësimore, nuk minimizon shpenzimet e tyre për librat me kosto të larta dhe nuk ka materiale në gjuhën shqipe.
TRANSPARENCA	TRANSPARENT	-
TERRITORI I REALIZIMIT	KOMBËTAR	-
KOHA E REALIZIMIT	JASHTË AFATIT	U premtua brenda muajit Mars 2019 dhe u publikua në muajin Prill 2019.

Pavarësisht numri të lartë të materialeve shkencore që përmban biblioteka online, studentët nuk arrijnë të gjejnë informacion që përkon me kurrikulat e tyre mësimore dhe nuk aksesojnë asnjë libër, artikull apo material shkencor në gjuhën shqipe.

Ky premtim nuk përkon drejtpërsëdrejti me kërkesën e studentëve që synoi të adresonte, pra minimizimin e kostove të librave që blihen në librari ose mungesës së tyre në bibliotekat e universiteteve, pavarësisht se investimi total nga buxheti i shtetit për Bibliotekën Digjitale është 687.825 USD pa TVSH për periudhën 2019 – 2022, realizuar me nënkontraktim nga Rrjeti Akademik Shqiptar. Nga na tjetër po për periudhën e marrë në monitorim nga 5 universitete publike të vëzhguara nga Qëndresa Qytetare, 3 prej tyre kanë shpenzuar 0 lek për blerje librash për bibliotekat e tyre dhe mijra euro për shpenzime luksi, pajisje zyrash dhe karburant makine.

https://ulibrary.rash.al

ULIBRARY

List Manual Contact Us

HAPAT PËR PËRDORIM

- Përzgjidhni universitetin tuaj**
Kujdes! Ju nuk mund të përzgjidhni universitet të ndryshëm nga universiteti ku jeni regjistruar.
- Përzgjidhni fushën e kërkimit**
Shkruani fushën që ju intereson të kërkoni dhe klikoni "Search".
- Identifikohuni**
Në formën që do ju shfaqet, vendosni email-in tuaj.

RASH Albanian Academic Research Engine (ALARE)

--Please select your institution-- Keyword Enter search term Search

➤ Premtimet Plus

➤ Monitorimi Janar-Mars 2019

Duke tentuar të kthejë vëmendjen nga arsimi i lartë dhe kënaqur studentët me politikat e saj në këtë drejtim, përveç përgjigjes ndaj 8 pikave, qeveria ndërmori edhe një sërë masash që lidheshin me punësimin e studentëve dhe investime të tjera në arsimin e lartë publik.

Portali www.punetembare.al

- Në kuadër të paktit për Universitetin u premtuan 1000 vende punë në administratën publike për studentët nëpërmjet një procedure "sui generis" duke plotësuar të gjitha pozicionet vakante të kategorisë ekzekutive me studentë ekselentë. Kjo mundësi u krijua nëpërmjet VKM nr. 766, datë 26.12.2018 e cila parashikon që për vitin 2019, pozicionet vakante të kategorisë ekzekutive (specialist dhe të barasvlefshme), në institucionet e administratës shtetërore, pjesë të shërbimit civil, të plotësohen me prioritet nga studentët e ekselencës të diplomuar duke filluar nga viti 2017 e në vijim, nëpërmjet punësimit të tyre me kontratë të përkohshme 1-vjeçare (njëvjeçare).
- Megjithëse sipas Pakatit për Universitetin afati zbatimit të këtij premtimi ishte muaji Maj 2019, nëpërmjet portalit "Punë të Mbarë" janë punësuar vetëm 373 studentë ekselentë deri në muajin Mars 2019.
- VKM 766 parashikon se kjo politikë qeveritare është e vlefshme vetëm për vitin 2019 dhe për studentët e punësuar nuk siguron qëndrueshmëri në shërbimin civil por vetëm eksperiencë pune.

Kampusi Universitar Tiranë

➤ Monitorimi Janar-Mars 2019

Nëpërmjet Urdhrit të Kryeministrit nr. 184, 26/12/2018 u ngrit grupi i punës përpërgatitjen e ngritjes dhe funksionimit të Kampusit Universitar të Tiranës. Ky grup do t'i paraqesë MASR dhe Kryeministrit raportin përfundimtar të studimit dhe plan-veprimin e ndërtimit të kampusit brenda datës 31 Mars 2019. Megjithëse jemi në fund të muajit Mars, ende nuk është bërë transparent raporti, plan-veprimi dhe grupi i punës.

Monitorimi Prill-Qershor 2019

PREMTIMET PLUS		
Treguesit	Rezultati	Shpjegimi
EFEKTIVITETI	DISI EFEKTIV	Deri në Mars 2019 u punësuan 373 studentë ekselentë, por megjithëse portali vijoi nuk ka më të dhëna mbi këtë proces.
TRANSPARENCA	JO TRANSPARENT	Mungojnë të dhënat mbi ekselentët e punësuar, fondin dhe projektin në dispozicion të Kampusit Universitar dhe shuma e grumbulluar nga Fondi i Solidaritetit.
TERRITORI I REALIZIMIT	KOMBËTAR	-
KOHA E REALIZIMIT	JASHTË AFATIT	Brenda muajit Maj duhet të ishin punësuar 1000 studentë ekselentë, shifër për të cilën nuk ka të dhëna dhe duhet të ishte krijuar fondi i solidaritetit.

Qeveria prej muajit mars 2019 **ku u punësuan 373 studentë**, nuk ka bërë publik asnjë shifër për numrin e ekselentëve të punësuar nëpërmjet portalit punetembare.al megjithëse **sipas premtimit në Paktin për Universitetin do të punësoheshin 1000 ekselentë deri në muajin Maj 2019.**

Ndërkohë që projekti i Kampusit Universitar u bë pjesë e platformës elektorale të kandidatit për kryetar bashkie të Partisë Socialiste në Tiranë duke prezantuar projektin për ndërtimin e 11 godinave të reja në Qytetin Studenti dhe ambienteve për lexim e studim. Pritet në vijim prezantimi i projektit dhe ndërhyrjeve konkrete në zonën e parashikuar.

Qeveria kishte parashikuar që brenda muajit maj 2019 të krijojë Fondin e Solidaritetit për arsimin e lartë, ku 20 % e fondit të përgjegjesisë sociale të korporatave që gëzojnë kontrata koncesionare të shkojnë për financimin e Arsimit të Lartë. Deri në muajin Qershor 2019 ende nuk ka asnjë shifër publike ose dokument publik që provon faktin e kalimit të kësaj shume në një investim për arsimin dhe studentët.

Komunikimi Publik

Koha televizive e transmetuar në komunikim publik dhe trasmetim live në mediat kombëtare dhe rrjete sociale "Pakti për Universitetin" nga Kryeministri & Qeveria në 6 muaj (19 Dhjetor 2018 - 17 Korik 2019)

Koha	Pershkrimi	Minuta	Dalje/takime publike
Janar- Shkurt- Mars	Prezantim dhe diskutim me studentë për Paktin mbi Universitetin	1049	25
Prill-Maj-Qershor	Prezantim dhe diskutim me studentë për Paktin mbi Universitetin	749	23
	Total	1798	48

Shtojca

REPUBLIKA E SHqipërisë
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT TË
ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
DREJTORIA E POLITIKAVE DHE STRATEGJIVE TË ZHVILLIMIT TË ARSIMIT, SPORTIT DHE
RINISË

Nr. 6361/1 Prot.

Tiranë, më 08.07.2019

Lënda: Kthim përgjigje kërkesës për informacion.

ORGANIZATËS QËNDRESA QYTETARE
Rruga 'Hoxha Tahsim', Pall. 'Vjetro' Ap. 23A, Tiranë

Në përgjigje të shkresës suaj datë 17.06.2019, regjistruar në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR) me nr. 6361 prot., datë 19.06.2019, ju informojmë mbi çështjet e paraqitura në kërkesën tuaj:

1. Listë me anëtarët e bordit të zgjedhur nga studentët përfaqësues të MASR-së në 14 universitetet publike ose të gjitha ato që dispononi:

Bashkëlidhur lista e anëtarëve të Bordeve të Administrimit të zgjedhur nga studentët përfaqësues të MASR-së.

2. Kostoja/buxheti total i Bibliotekës Online:

Për sa kërkohet në pikën 2, buxheti total i Bibliotekës Elektronike është 687.825 USD (dollarë amerikanë) pa TVSH, për periudhën 2019-2022.

3. Buxheti total në dispozicion të Kartës së Studentit nga MASR për vitin 2019:

Sa i përket buxhetit total në dispozicion të kartës së studentit, sqarojmë se në buxhetin 2019 të MASR-së nuk ka fonde të parashikuara, pasi kostot përballohen nga buxheti i Njësitë të Qeverisjes Vendore të cilat janë ofruar për implementimin e saj, sipas përcaktimeve të VKM-së numër 226 datë 17.04.2019.

4. Numri i disertacioneve të mbledhura për arkivin digital të disertacioneve si dhe numrin e titujve të identifikuar me plagjaturë:

Përsa i përket arkivit digital të disertacioneve, informojmë se MASR është në proces për ngritjen e tij në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Oltjon MUZAKA

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 23, AL 1001, Tiranë. E-mail: info@arsimi.gov.al www.arsimi.gov.al

Nr.	IAL	Anëtarët e bordit të administrimit zgjedhur nga studentët
1	Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër	Ted Paco
2	Universiteti Bujqësor i Tiranës	Marin Mema
3	Universiteti "Eqerem Çabej" Gjirokastrë	Erjon Nebiaj
4	Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	Anjeza Shiko
5	Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	Eteva Leskaj
6	Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan	Luan Rapi
7	Universiteti "Fan Noli" Korçë	Artur Balli
8	Universiteti i Arteve	Bujar Kapexhu

REPUBLIKA E SHqipërisë
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT TË ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
DREJTORIA E KONCEPTIMIT DHE FIZIBILITETIT TË PROJEKTEVE TË ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Nr. 2708/2 Prot.

Tiranë, më 04.04.2019

Lënda: Kthim përgjigje

ORGANIZATËS QËNDRESA QYTETARE
Tiranë

Në përgjigje të shkresës suaj drejtuar Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, regjistruar me nr. 2708 prot., datë 06.03.2019, ju bëjmë me dije se:

Në lidhje me kartën e studentit, në vijim të ngritjes së grupit të punës pranë Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, është duke u procedur me hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore përkatëse.

Në zbatim të urdhrin nr. 41, datë 24.01.2019 të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë "Për njoftimin e fillimit të procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit, mënyrën e vlerësimit të kandidatëve dhe afatin e dorëzimit të dokumentacionit", është bërë publike procedura, dokumentacioni dhe afati për aplikim për antar bordi si përfaqësues të MASR. Në vijim të vendeve vakante, është rihapur procedura për aplikim në zbatim të urdhrin nr. 171, datë 15.03.2019 "Për rishpalljen e procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit, mënyrën e vlerësimit të kandidatëve dhe afatin e dorëzimit të dokumentacionit". Lista me anëtarët e përzgjedhur është e aksesueshme në faqen zyrtare të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë www.arsimi.gov.al.

Në funksion të Arkivit Digital, numri i disertacioneve të depozituara është 12.

Numri i studentëve që ndjekin ciklin e parë të studimeve dhe përfillojnë reduktim të tarifës është 67225. Numri i studentëve që ndjekin ciklin e parë të studimeve dhe përfillojnë bursë është 9258. Numri i studentëve që ndjekin ciklin e dytë të studimeve dhe përfillojnë reduktim tarife është 3349. Efekti financiar në lidhje me reduktimin e tarifave dhe përfillimin e bursave është 2.1 miliardë lekë.

Lutemi gjëni bashkëlidhur një kopje të memorandumit të mirëkuptimit midis CNOUS dhe QSHA për realizimin dhe zbatimin e Kartës Evropiane të Studentit në Shqipëri, si

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 23, AL 1001, Tiranë. E-mail: info@arsimi.gov.al www.arsimi.gov.al


dhe një kopje të urdhrin nr. 104, datë 21.02.2019 të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë "Për disa ndryshime dhe shtesa në urdhrin nr. 353, datë 27.06.2018 "Për ngritjen e grupit të punës për monitorimin dhe administrimin e ankesave, sugjerimeve dhe nisave të portalit "shqipëriaqduam.al", të ndryshuar.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Oltjon MUZAKA

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 23, AL 1001, Tiranë. E-mail: info@arsimi.gov.al www.arsimi.gov.al



QENDRESA
QYTETARE